



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 26 Shkurt 2021

Nr. 104

VENDIM

Objekt: Për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj Bashkisë Tropojë

Kërkues: Partia Demokratike

Ndaj: Bashkisë Tropojë

Baza ligjore: Neni 19, paragrafi 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, paragrafi 2, dhe 91, 92, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9, datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi relacionin e administratës paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së, dokumentacionin e administruar gjatë procesit të hetimit administrativ,

VËREN:

I.

Vlerësimi paraprak

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është raportuar një denoncim në ndërfaqen e “Aktiviteteve të Ndaluara”, në rubrikën “Kallëzo”, nga subjekti politik Partia Demokratike, për shkelje të vendimit nr.9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.



Sipas denoncimit të datës 10.2.2021, me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 1471 ora 08:38, të kallëzuesit Partia Demokratike, pretendohet se: *“Zëdhënësi i Bashkisë Tropojë promovon aktivitete të ndaluara, duke shkelur nenin 91, pika 4, të Kodit Zgjedhor si dhe parashikimet e vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator pranë KQZ-së. Konkretisht zëdhënësi i bashkisë Tropojë z. Ismajl Bucpapaj publikon në FB e tij aktivitet të investimeve në Bashkinë Tropojë si dhe të një nisme projekt të bashkisë Tropojë i cili nuk dihet se kur do fillojë apo kur do të mbarojë kjo për të patur ndikim tek votuesit e rrethit Tropojë.*

Aktiviteti i parë është pjesëmarrja e kryetarit bashkisë Tropojë në inagurim të punimeve në datë 5 shkurt 2021 në orën 8.45 i publikuar në fb e zëdhënësit të bashkisë Tropojë, z. Ismajl Bucpapaj.

Aktiviteti i dytë është publikuar në fb e zëdhënësit në datë 8 shkurt 2021 ora 4:41, aktiviteti zhvillohet në sallën e këshillit bashkiak ku janë ftuar qytetarë të qytetit Bajram Curri për një projekt investimi i cili nuk dihet kur do fillojë por thjesht për të bërë fushatë në këtë takim është edhe kryetari Bashkisë Tropojë, Rexhë Byberi”.

Sipas denoncuesit: *“Këto janë aktivitete të ndaluara, shkelur nenin 91, pika 4, të Kodit Zgjedhor si dhe parashikimet e vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator pranë KQZ-së”.*

Sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesat lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e tij.

Neni 91, paragrafi 4 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, *“Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”* i ndryshuar, ka sanksionuar ndalimin e propozimit, miratimit ose nxjerrjen e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen apo heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive apo shpërblimeve, etj...përveçse nisma kushtëzohet nga gjendja e fatkeqësisë natyrore.

Duke qenë se denoncimet lidhen edhe me veprimtari të zhvilluara nga Kryetari i Bashkisë Tropojë, referuar pikës 2 të nenit 3 të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator, Komisioneri konstaton se kryetari i Bashkisë Tropojë z. Rexhë Byberi është subjekt i ngarkuar për zbatimin e këtij vendimi.



II.

Rrethanat e faktit

Komisioni Rregullator në KQZ, më datë 24.12.2020 ka miratuar vendimin nr. 9 “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Ky vendim, në nenin 4 të tij, përcakton detyrimin e institucioneve publike për të kryer raportimin e të gjitha veprimtarive publike në ndërfaqen e raportimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Sipas përcaktimeve të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator “Veprimtari publike”, janë të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut, apo të medias në kuptim të pikës 1 të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, të kryera nga subjektet e përcaktuara në këtë vendim, si dhe ato që kanë në agjendë informimin në periudhën katër mujore para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre.

Referuar denoncimit të mësipërm Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 1238 prot., datë 16.2.2021, i ka kërkuar informacion kryetarit të Bashkisë Tropojë për këto aktivitete.

Me shkresën nr. 539/1 prot., datë 18.02.2021, protokolluar në KQZ me nr. 1238/1, datë 22.2.2021, kryetari i Bashkisë Tropojë ka sqaruar se:

“Më datë 5 shkurt në fshatin Cërnicë, nuk është kryer asnjë aktivitet apo inaugurim i rrugës i nisur nga ne si investim përpara datës 25 dhjetor 2020, pra përpara afatit të përcaktuar nga ligji. Ne atë ditë me stafin teknik të bashkisë është bërë thjesht një kontroll rutinë për ecurinë dhe mbarëvajtjen e punimeve.

Aktiviteti i dytë nëse mund të quhet i tillë është një dëgjese publike e datës 8 shkurt e kërkuar nga vetë qytetarët e lagjes “Partizani” të qytetit të Bajram Currit, për tu njohur me projektin për rehabilitimin urban të kësaj lagje, kjo me sugjerim edhe të Kryeministrit, mbas letrës dhe email-it drejtuar atij. Sqarojmë se dëgjesa publike është bërë me pyetje përgjigje për çështje teknike drejtuar nga stafi teknik i bashkisë. Ka pasur pjesëmarrës një përfaqësues të banorëve dhe asnjë bisedë apo përmbajtje politike”. Bashkëlidhur kësaj shkrese edhe dokumentacioni sqarues si: email i Kryeministrit, kërkesat e banorëve, letrën e Kryeministrit, përgjigjen dhe kërkesat për investim”.



III.

Analiza ligjore

Neni 3, pika 2 e vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në KQZ, ka përcaktuar rrethin e subjekteve të cilët ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi sipas përcaktimit të cilit përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi janë edhe:

...kryetari i bashkisë zëvendësit dhe administrata e tij, gjatë periudhës kohore 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, e kanë të ndaluar të drejtojnë, të marrin pjesë apo të kontribuojnë në çfarëdolloj forme, në veprimtari publike të ndaluara sipas këtij vendimi.

Neni 3, paragrafi 3 i vendimit 9/2020 të Komisionit Rregullator parashikon si “veprimtari të ndaluara” edhe ato veprimtari që përfshijnë:

“Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndaloher propozimi, miratimi i akteve ligjore ose nënligjore, ose nxjerrja e tyre me qëllim informimin e publikut në lidhje me vendimmarrjen e institucionit miratues në faqen e tij zyrtare, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, faljet e kamat vonesave, të gjobave, të detyrimeve tatimore e doganore vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore ose të epidemisë/pandemisë, apo ka si qëllim zbatimin e një detyrimi ligjor me karakter ndërkombëtar apo zbatimin e një vendim gjyqësor të formës së prerë”.

Referuar sa më sipër, ndalimi lidhet vetëm në rastet kur veprimtaria publike është veprimtari e ndaluar në kuptim të përkufizimeve të nenit 3 të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator. dhe kjo veprimtari kryhet nga subjektet e përcaktuara në nenin 3 të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.

Në këtë rast nga ana e Komisionerit Shtetëror i Zgjedhjeve çmohet se nuk jemi në kushtet e ndalimit të përcaktuara në nenin 92 të Kodit Zgjedhor dhe nenin 3 të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.

Neni 3, pika 1.1, i vendimit 9/2020 përcakton se “veprimtari të ndaluara për t’u promovuar” janë veprimtaritë publike sipas përkufizimit të nenit 2, të këtij vendimi, për të cilat janë vënë rishtazi apo



posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve dhe që përfshijnë:

- a) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, me interes apo shtrirje territoriale kombëtare ose vendore në fushën e transporteve të çdo lloji, të energjetikës, të telekomunikacionit, të veprave ujore të çdo lloji, në shërbim dhe interes të publikut;
- b) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, kombëtare ose vendore, me karakter social dhe ekonomik, si edhe ato në funksion të mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, të kulturës, rinisë, sporteve dhe të arsimit publik në të gjitha nivelet, si dhe të infrastrukturës, në shërbim të interesit publik;
- c) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve për mbrojtjen dhe ruajtjen e monumenteve dhe të objekteve të paluajtshme të karakterit arkeologjik, historik, kulturor e shkencor dhe të objekte publike, ose për mbrojtjen dhe ruajtjen e objekteve të luajtshme me vlerë institucionale, historike, arkeologjike, kulturore ose shkencore;
- ç) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve strategjike, sipas legjislacionit në fuqi;
- d) mbështetjen dhe promovimin e objekteve të rindërtuara ose në proces rindërtimi për shkak të fatkeqësive natyrore

Gjatë analizës së fakteve dhe provave të paraqitura, çmohet se aktiviteti i Kryetarit të Bashkisë Tropojë nuk është një veprimtari e hapur për publikun dhe nuk ka pasur qëllim informimin e publikut dhe medias. Publikimi në profilin e Facebook të një veprimtarie administrative nga z. Ismajl Bucpapaj (referuar denoncimit zëdhënës i bashkisë Tropojë) nuk dëshmon karakterin publik të aktivitetit me fonde të dhëna rishtas në dispozicion me qëllim informimin e medias.

Për sa i përket pretendimit për aktivitetin e dytë, çmohet se ajo është një dëgjese publike e organizuar për projekte të pafinancuara me fonde të vëna rishtas dhe për zbatimin e të cilave Bashkia Tropojë ende nuk disponon fonde.

Kallëzuesi nuk ka paraqitur prova/ fakte apo të dhëna për të dhënë indicie të besueshme për natyrën publike apo promovuese të aktivitetit me qëllim informimin e publikut nëpërmjet medias, në mënyrë që KQZ të kishte indicie të besueshme për kërkimin e provave.

Referuar provave të paraqitura nga Bashkia Tropojë rezulton se ky aktivitet është zhvilluar në bazë të kërkesave të banorëve të komunitetit në lidhje me rehabilitimin urban të lagjes dhe jo një “veprimtari e ndaluar për t’u promovuar” në kuptim të përkufizimeve të nenit 3 të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.



Publikimi në profilin e Facebook të një veprimtarie administrative nga z. Ismajl Bucpapaj (referuar denoncimit zëdhënës i bashkisë Tropojë) nuk dëshmon karakterin publik të aktivitetit me fonde të dhëna rishtas në dispozicion me qëllim informimin e medias.

Referuar denoncimit të mësipërm, këto veprimtari të Kryetarit të Bashkisë Tropojë nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të provojnë se janë veprimtari të ndaluara në kuptim të përkufizime të veprimtarive të ndaluara të përcaktuara në nenin 3 të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, paragrafi 1, shkronja “dh”, “f”, “n” paragrafi 2, dhe nenet 91, 92, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

V E N D O S:

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ për arsye se nuk konstatohen elemente të shkeljes së dispozitave të nenit 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 3 të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në KQZ.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në KAS brenda 3 ditëve nga njoftimi i tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

